



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:185847
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06233785

C.nr.1847/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në çështjen juridike të paditësit D. I. nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av.Lutfi Tahiri nga Prishtina, kundër të paditurit A. Q. me adresë në rr."Nexhip Dragaj " p.nr.(ish rruga e BIP), i përfaqësuar sipas autorizimit nga av.Zenel Ademi, me ndërhyrësin Januz Ibrahim nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Rexhep Kaçaniku nga Mitrovica, lidhur me objektin e kontestit Vërtetim i pronësisë, jashtë seance gjyqësore me datën 01.10.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET POSHTË** si e palejuar padia e paditësit D. I. nga M, kundër të paditurit A. Q. nga M., me objekt të kontesiti Vërtetim i pronësisë, për shkak se është çështje e gjykuar.
- II. REVOKOHET** aktvendimi i datës ..., me të cilin i është lejuar ndërhyrja, ndërhyrësit J.I.
- III. REFUZOHET** kërkesa e datës ... ndërhyrje në këtë çështje kontestimore e ndërhyrësit J.I

Arsyetim

Paditësi, me datën

Gjykata, me datën ..., ka mbajtur seancën përgatitore, në të cilën i autorizuari i të paditurit i ka dorëzuar gjykatës certifikatën e lindjes për A. Q. dhe kontratën për dhuratën me numër e datës Andaj, gjykata duke marrë parasysh shkresat e dorëzuara dhe shkresave që gjenden në lëndë, gjeti se kjo çështje është çështje e gjykuar dhe atë me aktgjykimin e formës së prerë C.nr..... i datës ..., në bazë të padisë së paditësit Sh. Q. nga M., kundër të paditurit D. I. Gjykata, konstaton se Sh.Q. është babai i tani këtu të paditurit A. Q. dhe atë në bazë të certifikates së lindes për A. Q. e dates ..., ku babai S. Q... ne bazë të kontratës për dhuratën me numër ... e datës ..., i ka bartur djalit A. Q. pronën me numës P-..., e cila prone është objekt kontesti për të cilën çështja është gjykuar me aktgjykimin e lartëcekur.

Gjykata, vlerëson se me këtë rast kemi të bëjmë me res judicata, për shkak se objekti i kontestit është i njëjtë me atë të zgjidhur me aktgjykimin e formës së prerë C.nr.... i datës ... përkatësisht

ngastra kadastrale me numër P-..., si dhe palët ndërgjyqëse janë të njëjta për shkak se këtu paditës është Delia Ibrahimimi i cili në lëndën me numër C.nr.... ka qenë i paditur, ndërsa paditësi Aladin Qoroviq, është i biri i Sherafedin Qoroviq i cili në lëndën C.nr..... ka qenë paditësi, andaj konsiderojmë se sa i përket subjektiviteti në këtë rast është bartur nga babai tek i biri dhe palët konsiderohen të jenë të njëjta.

Nga këto arsye gjykata konstatojë se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me qështje të gjykuar, sepse aktgjykimi i lartëcekur e ka formën e prerë dhe nuk mund të zhvillohet më procedura kontestimore për të njëjtën çështje.

Gjykata, ka revokuar aktvendimin e datës ..., me të cilin i është lejuar ndërhyrja, ndërhyrësit Januz Ibrahimimi dhe ka refuzuar kërkesën e datës ... për ndërhyrje në këtë çështje kontestimore të ndërhyrësit Januz Ibrahimimi, për shkak se duke marrë parasysh se mes palëve ndërgjyqëse kjo është një çështje e gjykuar dhe nuk mund të zhvillohet tjetër procedurë, atëherë ndërhyrësi çdo kërkesë për këtë objekt të kontestit mund ta paraqes në procedure të veçantë në bazë të padisë së veçantë e cila mund t'i drejtohet pronarit të ngastrës kontestuese.

Andaj, në bazë të nenit 391 pika d) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.1847/2024, datë 01.10.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.